



ORGANIZATA PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË

## EDUKIMI DHE ZHVILLIMI I POLICISË

Misionit të OSBE-së në Kosovë, shtyllës së tretë të Administratës së Përkohshme të KB-së (UNMIK-ut), i jipet mandati mbi ndërtimin e institucioneve dhe demokracisë dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit. Departamenti i saj për zhvillim dhe edukim policorë është i ngarkuar me punë mbi zhvillimin dhe trajnimin demokratik të Shërbimit të ri Policorë të Kosovës i cili do të mbështes sundimin e ligjit dhe respektimin e mëtejshëm për të drejtat e njeriut.

### Hyrje

Shkolla e Shërbimit Policorë të Kosovës (SHSHPK) e udhëhequr nga ana e OSBE-së është themeluar në shtator të 1999 me synim që të krijojë një forcë moderne policore e cila do të kthej besimin tek zbatuesit e ligjit dhe në mënyrë efikase të zbatojë parimet e kryerjes së detyrave policore në bashkëpunim me komunitetin.

Departamenti për Zhvillim dhe Edukim Policorë (DZHEP) ka për detyrë zhvillimin dhe krijimin e një trajnimi themelor demokratik policorë për 7,300 (numër që është përcaktuar si i nevojshëm për zbatim të suksesshëm të ligjit) policë lokal të rekrutuar, deri në dhjetor 2005. Deri më sot, përafërsisht 7,000 policë kanë diplomuar nga SHSHPK-ja.

### Seleksionimi dhe rekrutimi

Përderisa OSBE-ja trajnon kadetët, policia e UNMIK-ut së bashku me Shërbimin Policorë të Kosovës (SHPK-në) janë plotësisht përgjegjës mbi processin e aplikimit për SHSHPK-në. Gjatë seleksionimit, bëhen përpjekje të ndërgjegjshme që të rekrutohen meshkuj dhe femra nga regjione të ndryshme të cilët pasqyrojnë lloj-llojshmërinë etnike e kulturore të Kosovës.

Të gjithë aplikantët duhet të kenë të kryer shkollën e mesme (apo të nivelit të njejtë) të jenë të moshës 21 deri në 55 vjeçare dhe të jenë banorë të Kosovës. Ata gjithashtu duhet të jenë në gjendje të mirë fizike, të kenë karakter të fortë moral dhe të jenë tolerant dhe të gatshëm që të punojnë me njerëz nga etnicitete të ndryshme. Dhe së fundi ata duhet të shfaqin përkushtim për të mbrojtur të drejtat njerëzore të të gjithë personave.

Aplikantët që plotësojnë këto kritere i nënshtrohen një mori testeve psikologjike si dhe hetimit të hollsishtëm të së kalurës së tyre.



PËR INFORMATA KONTAKTONI:  
Zyrën për informim publik  
Selia e misionit të OSBE-së,  
38000 Prishtinë

TEL: +381 38 500 182  
Fax: +381 38 500 188,  
[www.osce.org/kosovo](http://www.osce.org/kosovo)  
[press.omik@osce.org](mailto:press.omik@osce.org)



Shkolla e SHPK-së gjatë pesë viteve të fundit është angazhuar në krijimin e një shërbimi demokratik policor i cili do ta mbështes shtetin ligjor dhe të drejtat e njeriut për çdo individ.

## Programet trajnuese

Me të përfundura trajnimin në shkollë, aplikantët i nështrohen një mori programeve trajnuese para se të caktohen me detyrë në SHPK-ë.

### Kursi i trajnimit themelorë

Tash për tash, studentët që hyjnë në SHSHPK i nështrohen trajnimit themelorë policorë prej 20 javësh. Planprogrami themelorë mbështetë parimet e kryerjes së punës policore në demokraci dhe të drejtave të njeriut, dhe mbulon shumëllojshmërinë e gjërë të shkathtësive që kërkohen për kryerjen e punës policore në shoqëri demokratike. Këto përfshijnë: detyrat patrolluese, hetimet e krimit, mbledhja e dëshmimeve forenzike (të krim-teknikës), kontrollimi i komunikacionit (trafikut), taktikat mbrojtëse, përdorimi i forcës dhe armët e zjarrit, ndihma e parë, ligjet e aplikueshme dhe teknikat e intervistimit. Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut janë të gërshetuara në të gjitha temat thelbësore, si në klasë edhe në ushtrimet praktike në teren. Mësimi mbahet në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

Gjashtëdhjetë ndërkombëtarë të OSBE-së dhe 105 instruktorë policorë të SHPK-së, gjithashtu edhe mbi 200 vetë si personel vendorë, duke përfshirë 3 ekspertë ligjorë vendorë, i udhëzojnë studentët nëpër trajnimin e tyre çdo ditë dhe ndihmojnë në funksionimin e përgjithshëm të shkollës.



Kadetët e diplomuar të shërbimit policor kanë marrë përgjegjësinë për krijimin dhe sigurimin e një ambienti të sigurtë për të gjithë ata që jetojnë në Kosovë.

Në mënyrë që të fillohet procesi i trajnimit Misioni i OSBE-së ka renovuar akademinë policore në Vushtrri, ndërtesë që mund të pranojë 650 studentë dhe është e pajisur me mjete moderne për ligjerim, dhe pajisje trajnimi.

### Trajnimi fushorë

Nga ata të cilët me sukses diplomojnë në kursin i trajnimit themelorë kërkohet të përfundojnë trajnimin e strukturuar 20 javorë në teren me policinë e UNMIK-ut. Trajnimi fushorë fokusohet në zbatimin praktik të njohurive të fituara gjatë kursit dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të shkathtësive për kryerjen e detyrave në bashkësi. Gjatë kësaj faze të stërvitjes, të sapo diplomuarit nga SHSHPK-ja caktohen në detyrë me policët e UNMIK-ut dhe me policët kryesorë për trajnim fushorë të SHPK-ës dhe policët për trajnim fushorë të SHPK-ës, të cilën kryejnë detyrat e këshilluesve (mentorëve) dhe vlerësojnë punën e përgjithshme të sapo diplomuarve.

Pas përfundimit të suksesshëm të 40 javëve të kombinuara të mësimin në klasë dhe atij fushorë, policët e ri fitojnë të drejtën për tu certifikuar, për detyrë të pavarur, dhe bëhet anëtar i plotëfuqishëm i SHPK-së.

OSBE-ja vazhdon të mbajë kursin për zyrtarët primarë të trajnimit fushorë për grupet e zgjedhura të policisë ndërkombëtare të UNMIK-ut. SHSHPK-ja gjithashtu ofron kursin dyjavorë për Oficerët Fushorë të Trajnimit (FTO) për zyrtarët e zgjedhur të SHPK-së të cilët kanë filluar të ushtrjnë punën e tyre monituese në fillim të vitit 2004. Kurset e FTO-së janë të dizajnuara për ta standardizuar programin e instruksioneve duke asistuar si zyrtarët e SHPK-së dhe ata ndërkombëtarë në zgjerimin e kapaciteteve të tyre si trajnerë gjatë punës.

### Trajnimi për ricertifikim

SHSHPK-ja gjithashtu drejton programin e ricertifikimit për trajnimin e të gjithë policëve të SHPK-ës. Qëllimi i këtij trajnimi është që rregullisht të kontrollojë kompetencën dhe të vërtetojë aftësitë e policëve të SHPK-së në fusha të veçanta. Thjeshtë ricertifikimi përfshin sigurimin e aftësisë së tanishme të përdorimit të armës së zjarrit, ndihmës së parë, taktikave vetmbrojtëse, dhe identifikimin e drogës.

### Trajnimi për mbikqyrës / udhëheqjes

SHSHPK-ja gjithashtu drejton kurset e vijës së parë, udhëheqjes së mesme, dhe të udhëheqjes/mbikqyrjes të lartë për policë të zgjedhur. Pas përfundimit të 100 orëve të kursit të vijës së parë, këta policë i bashkangjiten policëve rezervë të mbikqyrësve të mundshëm të SHPK-ës.

Deri më sot, UNMIK-u ka graduar një numër të konsiderueshëm të policëve të SHPK-ës të cilët kanë përfunduar këtë kurs për gradat: Kolonel – 5; Nën-Kolonel – 13; Major – 9; Kapiten – 52; Toger – 129; dhe Rreshter – 702.



Trajnimet gjithëpërfshise në Shkollën e SHPK-së përgadisnin kadet të rinjë për detyrën e tyre sfiduese. Për të siguruar një shërbim policor cilësor, kadetët në shërbim kalojnë nëpër trajnime dhe ekzaminime për ricertifikim.

### Programi çertifikues për instruktorë

Në gusht të vitit 2001, diplomuan 16 instruktorë të SHPK-së në Programin për çertifikim të instruktorëve, një trajnim intensiv 12-javorë, që i bëri ata instruktorë të parë të çertifikuar të SHPK-së. Deri në fund të 2002 edhe 100 policë shtesë janë trajnuar dhe çertifikuar si trajnerë dhe janë caktuar në lëmitë kryesore të programit për ricertifikim. Për gjatë viteve 2003 dhe 2004, SHSHPK-ja ka trajnuar dhe çertifikuar edhe 256 trajnerë tjerë të cilët tanimë janë të caktuar me detyrë në programe të ndryshme të trajnimeve policore.

Tashmë SHSHPK-ja ka 105 instruktorë të SHPK-së (Shqiptarë e Serb të Kosovës), si dhe 3 avokat vendorë

### Projektet e veçanta

Që nga themelimi i saj, DEZHP ka punuar që të ndihmojë në vendosjen e konceptit të kryerjes së detyrave policore sipas nevojave të komunitetit. Duke punuar me SHPK-në, ka zhvilluar dhe implementuar një numër projektesh në këtë lëmi.

Si pasojë e trazirave të marsit 2004, DEZHP-ja ka përqëndruar përkrahjen e saj në projektet të cilat forcojnë marrëdhëniet në mes të policisë dhe të rinjëve si dhe në rritjen e sigurisë dhe mirëqenies së komuniteteve vendore. Si shtesë e trajnimeve të ofruara në SHSHPK, DEZHP ka caktuar programe të policisë në komunitet në gjashtë komuna me përbërje shumetnike: Dragash; Fushë Kosovë; Gjakovë, Kaçanik; Leposaviq; Novoberdë; Rahovec dhe Vushtri.

DEZHP-ja gjithashtu ka organizuar seminar shumetnik mbi krimet e organizuara. Seminari ka përkrahur idenë që shoqëria, në tërësi, ka nevojë të punojë për çrrënjosjen e krimit të organizuar. Kjo edhe më tepër mbështetë aplikimin e konceptit të kryerjes së aktiviteteve policore në komunitet.

### Studentët / Statistikat e kursit

Nga 16 tetori 1999, kur gjenerata e parë e 176 kadetëve diplomoi nga SHSHPK-ja, deri më 30 tetor 2004, 29 gjenrata dhe 6,953 policë janë trajnuar në SHSHPK.

Gjenerata e 30-të me 345 kadetë parashihet që të përfundojë trajnimin themelorë më 28 maj 2005, me ç'rast SHPK-ja do të ketë përqindjet e dhëna në vijim mbi përkatësinë etnike dhe gjinore:

#### Përkatësia etnike - klasët 1 – 30

Shqiptarë të Kosovës	Serb të Kosovës	Të tjerës*
84%	10%	6%
* Romë, Turq, Goran, Boshnjak; dhe Mysliman të Kosovës		

#### Klasët në bazë gjinisë klasët 1 – 30

Meshkuj	Femra
84%	15%

Klasa	# e studentëve	Data e diplomimit
01	176	16 tetor 1999
02	173	19 shkurt 2000
03	230	22 prill 2000
04	215	20 maj 2000
05	276	17 qershor 2000
06	314	15 korrik 2000
07	312	12 gusht 2000
08	281	16 shtator 2000
09	269	14 tetor 2000
10	292	18 nëntor 2000
11	310	16 dhjetor 2000
12	287	3 shkurt 2001
13	260	3 mars 2001
14	250	14 prill 2001
15	201	13 maj 2001
16	260	15 shtator 2001
17	284	15 janar 2002
18	296	30 mars 2002
19	285	29 qershor 2002
20	283	14 shtator 2002
21	81	14 dhjetor 2002
22	253	14 dhjetor 2002
23	22	12 prill 2003
24	96	12 prill 2003
25	195	28 qershor 2003
26	202	27 shtator 2003
27	185	12 dhjetor 2003
28	328	29 maj 2004
29	337	30 tetor 2004
30	345	4 qershor 2005

**Totali: 7,289**

SHËNIM: Gjatë pesë viteve të fundit disa policë të trajnuar kanë braktisur shërbimin. Pritet që gjenrata e 31 të numërojë 350 studentë.

## Rezultatet

Policët e SHPK-së që patrollojnë në Kosovë tanimë ia kanë kaluar në numër homologëve të tyre të Policisë civile të KB-së dhe sipas të dhënave të përgjithshme, kryjnë detyrat e tyre në mënyrë profesionale.

Megjithatë krijimi i një shërbimi të ri policorë fillimisht e shtyri SHSHPK-në që të zhvillojë dhe ofrojë një program inteziv të trajnimit themelorë, kështuqë më vonë të filloi të përqëndrohet në mbikqyrje dhe menaxhim, si dhe trajnime të specializuara dhe në kuadër të shërbimit.

SHSHPK-ja gjithashtu ofron trajnime edhe për policinë kufitare dhe oficerë të shërbimit korrektues. Veç kësaj, në të 2005-tën, në bashkëpunim me partnerët bilateral do të vazhdojë të ofrojë trajnime jashtë programit, mbi krimet e organizuara, negociata për pengje, armë dhe taktika speciale dhe policinë në bashkësi.



*Kadetet të gjinisë femrore inkurajohen të aplikojnë në Shkollën e SHPK-së me qëllim të sigurimit të balancit gjinor në shërbim.*